



ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



NEWSLETTER

JANAR - MARS 2021

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve boton revistën e parë për vitin 2021, për periudhën janar-mars.

AIDA ka kthyer në traditë botimin e revistës periodike tremujore. Çdo vit, publikon 4 numra të newsletter-s me informacione të vlefshme për audiencën, grupet e interesit, bizneset dhe publikun më të gjerë. Në formatin e një 'buletini' elektronik, ndarë në disa rubrika, revista pasqyron evente, takime, webinare, sesione informuese, Door to Door, AfterCare, trajnime, vizita, forume, panaire, bashkëpunime, botime e publikime, përditësime dhe informacione të rëndësishme mbi sipërmarrjen, nisma apo fushata të rëndësishme që AIDA ndërmer.

Secili nga numrat e revistës elektronike është njëherësh një 'dokumentim' që përmbledh aktivitetet përgjatë 3 muajve, një burimi informacioni që shfaq profilin e konsoliduar të AIDA-s dhe fushave që ka në fokus.


AIDA zhvillon veprimtarinë e saj për të fuqizuar zhvillimin ekonomik të vendit, sidomos me përkrahjen e prodhuesve dhe produkteve vendase. Në funksion të një diplomacia ekonomike, jep kontribut në zgjerimin e bashkëpunimit me vende partnere dhe strategjike nëpërmjet dialogut me institucione që kanë në fokus investimet, rolit aktiv dhe pjesëmarrjes së vazhdueshme në evente që kanë si objektiv promovimin e Shqipërisë në fusha të ndryshme.

Mbështetja dhe asistimi profesional i investitorëve të huaj është një aspekt me prioritet të veçantë. Agjencia, veç tërheqjes së investimeve direkte në vendin tonë, ndërmer nisma për rritjen e konkurrencës së Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, (NVM) zhvillimin e sektorit privat, përmirësimin e klimës së biznesit, punon për promovimin dhe ofrimin e ndihmës për eksportet e mallrave dhe shërbimeve, duke bashkëpunuar me subjektet e tregtisë së jashtme dhe organet shtetërore.

Gjithashtu, në ndihmë të bizneseve vendase dhe produkteve 'Made in Albania', AIDA vijon fushatën promovuese 'E Dua Shqip'.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve është proaktive dhe ka si përparësi mbështetjen e interesave ekonomike të Shqipërisë, tërheqjen e investimeve të huaja, promovimin e vendit si destinacion i veçantë dhe i qëndrueshëm turistik, si partner i besues tregtar/i investimeve të huaja në sektorë potencialë si energjia, turizmi, infrastruktura, bujqësia etj., si dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të brendit shqiptar.

Për të rejtat më të fundit mbi Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve vizitoni:


 @aida__albania  AIDA - Albanian Investment Development Agency

 info@aida.gov.al  aida.gov.al  +355 (0)42 251 001  @investinalbania

 AIDA - Albanian Investment Development Agency

SHESHO KURBËN!

RESPEKTO MASAT PARANDALUESE



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ju kujton që duhet të jemi të gjithë të kujdesshëm dhe të respektojmë masat parandaluese kundër COVID-19. Sot më shumë se çdo ditë ka nevojë për solidaritet.



AIDA TEAM | KONTAKT

email: info@aida.gov.al
tel: +355 042 251 001
web: www.aida.gov.al

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në përshtatje me situatën e krijuar nga COVID-19, ju rikujton se ne vazhdojmë të jemi në dispozicion me shërbimet tona si më poshtë:

Dorëzimi i aplikimeve ose dokumenteve për statusin e investitorit strategjik, bëhet nëpërmjet Postës Shqiptare.

Dokumentet e çfarëdollojshme përcillen përmes Postës Shqiptare, nëpërmjet adresës zyrtare të AIDA-s, info@aida.gov.al ose pranë zyrave të AIDA-s duke u lidhur më parë me stafin tonë.

Për çdo informacion, ju lutem vizitoni faqen web www.aida.gov.al dhe rrjetet tona sociale për përditësime.

AIDA

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) është pjesë e aparatit organizativ të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

AIDA shërben si një nyje lidhëse mes investitorëve të huaj dhe Qeverisë së Shqipërisë.

Qëllimi i saj është të ndërmarrë nisma të vazhdueshme që gjenerojnë rritje të qëndrueshme ekonomike, biznese të zhvilluara, mundësi për tërheqjen e investimeve të huaja në përputhje me profilin e burimeve dhe aspiratat e Shqipërisë.

AIDA është promotore e markës “Made in Albania”.

Në misionin e vet, vijon të mbështesë bizneset vendase duke zhvilluar sidomos sektorët prioritarë.

Gjatë vitit 2020 AIDA ka dhënë mbështetje konkrete ndaj biznesit vendas, ka ndikuar në thjeshtimin e procedurave për investitorët e huaj, vendosjen e bashkëpunimeve të reja dhe të suksesshme me institucionet, në ndihmë të klimës së investimeve; përcimin e informacionit të përditësuar për investitorët e huaj dhe ata vendas; realizimin e disa “outreach campaign” në sektorët potencialë, realizimin e disa pyetësorëve për kompanitë që kanë investuar në Shqipëri për t’u njohur me nevojat e tyre për përmirësimin e klimës së biznesit.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve shënjon një strategji novatore, një vizion të ri në mënyrën e qasjes dhe zhvillimit të potencialit ekonomik të Shqipërisë.



FUSHATA #EDUASHQIP NË MBËSHTETJE TË BIZNESEVE SHQIPTARE DHE PRODUKTEVE ‘MADE IN ALBANIA’

AIDA, si një pikë qendrore për sipërmarrjen është gjithmonë në mbështetje të prodhuesve shqiptarë, që gjithnjë e më shumë po shtojnë produkte nën markën “Made in Albania”, duke ofruar për tregun vendas dhe atë të huaj cilësi dhe vlerat tona tradicionale. E Dua Shqip është fushata promovuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve/AIDA në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve ‘Made in Albania’.

Qëllimi ynë është të njohim, zgjedhim dhe duam çdo ditë produktet shqiptare. T’i japim jetë artizanatit, produkteve autentike dhe unike duke bërë bashkë çdo copëz që formon historinë e Shqipërisë me vlera.

Kjo nismë synon të krijojë një katalog sa më të plotë dhe gjithëpërfshirës. Nëse jeni një biznes apo artizan, prodhoni të mira nga duart tuaja, doni t’i prezantoni dhe t’i ktheni në një “atraksion turistik” për vendin e origjinës, na dërgoni përshkrimin dhe foto të produktit.

Rrënjët janë të rëndësishme.

Nëse dëshironi të bëheni pjesë e kësaj fushate, na kontaktoni në info@aida.gov.al ose në numrin e telefonit 04 225 1001.



AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Gjalpë Arre

E keni provuar ndonjëherë gjalpën e arrës? Ky produkt 100% vendas, vjen në një paketim 200 gram nga kompania "Pemla".

Ky gjalpë ka vlerat më të larta të Omega 3 nga të gjithë arrorët, ka sasi të larta antioksidantësh si vitamina E dhe përbërës të tjerë bimorë që quhen polifenolë. Ndhomon në ujën e rrezikut nga sëmundjet e zemrës.

Zgjijdh tëndën, kontakto me kompaninë Pemla në: email: info@pemla.al ose në numrin e telefonit: 0692925333.



AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



"Margjelo" punime filigrani

Edhe pse në kohën moderne gjithçka po shkon drejt automatizimit, ende ka njerëz që krijojnë me dorë, durim e dashuri stoli argjendi dhe suvenirë autentike. Margjelo filigran është krijuar si një brand i ri vitin e fundit në qytetin e Shkodrës, që dëshiron të mbajë gjallë traditën.

Të gjitha punimet janë me material argjendi, duke ruajtur tradicionalen, por edhe duke i pasuruar me element bashkëkohorë.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: margjelofiligranalbania@gmail.com ose në 0677173444.



AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Vaj ulliri "Oriku"

Në fushat e Dukatis, në Vlorë shtrihen mbi 80 rranjë ullinj 20 vjeçar të varietetit "Kalinjt".

Klima e favorshme mesdhetare, e karakterizuar nga një verë e gjatë dhe e nxehtë dhe një dimër jo shumë i ftohtë, i jep ullit jetëgjatësi dhe bën të mundur prodhimin e vajit të ullirit të një cilësie të lartë.

Vaji i ullirit "Oriku" ka një shije karakteristike shumë të mirë dhe tepër aromatik.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: auronelaj@gmail.com ose në 0693325142.



AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Vera "Balaj"

Kantina Balaj është krijuar nga pasioni dhe dëshira që vëllezërit Balaj kishin për verën, dhe pas një pune të gjatë në këtë fushë në zonën e Toskanës, Itali. Vreshtat e kantinës Balaj gjenden në zonën e Risliës dhe Alikokë, në rrethin e Vlorës.

Cilësia e rrushtit për shkak të klimës bregdetare, por edhe maleve përreth vreshtave ka sjellë prodhimin e verës të cilësia shumë të lartë, ku dallohet vera "Vlosh I Vlorës", Sheshi i zi 2016, Norusko 2018 (caberlot) etj.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: balajartan@gmail.com ose në 0692955247.



AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Kërpudha Porçini të thata

Kërpudhat porçini mbledhen në pyjet e lisit, pishës dhe ahut në lartësitë 800-1500 metra mbi nivelin e detit, në zonën e Pukës. Agropuka i than ato nëpërmjet një teknologjie zvicerane me avull në temperaturën 47°C në mënyrë që të ruajnë të gjitha vlerat ushqimore.

Kërpudhat e thata përdoren në ushqime të ndryshme, për t'i shtuar sa më shumë shije gatimit të tryezave shqiptare.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: agropuka@gmail.com ose në 0696066909.



AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



Vera 'Dukat'

Kantina Dukat shtrihet në fushën e Dukatis, 3 km larg detit, në një tokë të kuqe skeletike gurishtore, me diellëzim të përhershëm. Kultura që spikat më tepër është rrushi, i cili është i organizuar në vreshta, nga të cilat prodhohet vera "Dukat" me një shije dhe aromë të veçantë.

Që nga viti 1993, vera e llojit Merlot, ka krijuar një traditë jetëgjatë të degustimit dhe shijimit të saj.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: teo.kapo@hotmail.com ose në 0692160410.



Birra 'Puka'

E freskët dhe pa konservantë, Birra Puka përpunohet në sasi të vogla nga uji më i pastër i burimeve lokale, duke marrë një ngjyrë tipike qelbari dhe një shije të jashtëzakonshme. Ajo është një birrë artizanale, e prodhuar me fermentim të jashtëm dhe uje bjeshkë të malësisë Pukjane, i cili njihet për përqindjen e lartë të magnezit.

Birra Puka prodhohet në tre varietete që janë: vishnje, pils dhe krudo.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: xhimibegeja@yahoo.com ose në 0672070306



Verë e kuqe 'Selenica'

Në zonën e fshatit Trevllazër, në Vlorë, përzgjidhet rushi nga vreshat me ekspozimin më të mirë në diell, në lartësi jo shumë të mëdha. Vera e kuqe 'Selenica' e llojit Merlot ka një aromë karakteristike dhe të veçantë, që e bën të dalleshme nga të tjerat, pasi nuk përmban konservantë.

Shija e verës 'Selenica' lihet të maturohet për tre vite dhe është e vullosur në shishe qelqi, ku fillon procesin e vjetërimit.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: kristoselenica@gmail.com ose në 0682076666.



Jufka "Zerja"

Jufkat e Dibrës, me një histori më shumë se 300 vjeçare, dallohen si mjeshtëria e traditës shqiptare.

Ky produkt është prodhim autokton i zonës së Dibrës së Madhe nga "Zerja Agroturizëm".

Jufkat "Zerja", vijnë për ju të punuara me dorë dhe me përbërës bio duke ruajtur të njëjtën shije autentike.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: agro_zerja@yahoo.com ose në 069 937 7337.



Hurma të thata

Në Pukë, që nga viti 2001, Agro-Puka është aktive në përpunimin e frutave të ndryshme. Frutat e thata realizohen nga tharja që u bëhet frutit të zonës, siç është hurma. Tharja e tyre bëhet me ajër të dehidratuar duke e tharë në temperaturë deri në 47°C, çka e lejon produktin përfundimtar të ruajë vlerat ushqyese.

Hurmat e thata mund të konsumohen në vend të frutave apo si pjesë e gatimeve të ndryshme që kërkojnë përfshirjen e frutave.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: agropuka@gmail.com ose në 0696066909.



Kallmet Rezervë - Kantina ARBËRI

Në vreshat e Bukmirës dhe Kodër Rrëshenit, vera e kantinës ARBËRI përfaqëson historinë dhe traditën e këtyre zonave. Kallmet Rezervë vjen në një ngjyrë të kuqe, të thellë e të vështirë për t'ia hequr sytë. Ka një harmonizim të përkryer midis aromës së frutave të ndryshme të pyllit, të përziera me shijen e biotonicës. E pasuruar edhe nga maturimi në bute druri lisi, për një periudhë 18 mujore dhe e shijshme në degustim, vera Kallmet Rezervë është një shije e cila mbetet për një kohë të gjatë.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@kantina-arberi.com ose 068 808 7806.



Miell "Diamond"

Fabrika e Miellit "Diamond" ka filluar prodhimin në vitin 2012, duke aritur të prodhojë më shumë se 20 lloje produktesh të ndryshme mielli. Fabrika e Miellit "Diamond" prodhon të gjitha llojet e miellit si: për gatime familjare, furra buke, piceri, linja prodhimi, pastaçeri si dhe për çdo lloj produkti me bazë mielli. Teknologjia bashkëkohore dhe cilësia e lartë e grurit e bëjnë miellin "Diamond" ideal dhe të domosdoshëm për çdo lloj gatimi.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@miellcliamond.com ose në 068 90 43 666.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



zojdh të vendit

Kantina ARBËRI - Shesh i Bardhë

Kantina ARBËRI që nga viti 2002, prodhon verën 'Shesh i Bardhë', e cila njihet për cilësinë dhe aromën e veçantë me shijen e mollës jeshile.

Me pak aciditet, e thatë dhe sepide, ajo është një verë që pihet e fresket. Ngjyra e saj e verdhë kashite e zbehtë, me refleksa të jeshilta, transparente gati në kristalin i shkon për shtat kodrave të larta të Mirditës, zonës në të cilën ajo prodhohet.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@kantina-arberi.com ose 069 20 57 553.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë

zojdh të vendit

Artistike Zadrime



Artistike Zadrime është ngritur në vitin 1993 dhe prej asaj kohe ka sjellë në treg traditën e endjes në tezgjah duke e modernizuar atë. Gjithmonë në kërkim të modernes, pa lënë mënjandë trashëgiminë kulturore, artistike Zadrime promovon punën e endjes në tezgjah dhe mbështet punën e gruas.

Nëse doni të keni veshje, aksesorë si çanta apo tekstile për shtëpinë sipas traditës, Artistike Zadrime, iu përgjigjet kërkesave tuaja.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@artistikezadrime.com ose 069 26 38 164.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



zojdh të vendit

Mjaltë Kastrioti

Mjaltë "Kastrioti" mbarëshehton mbi 50 zgjoje bletësh në fshatin malor Ogdunan të Përmetit, duke krijuar parkun e bletëve. Çdo vit, numri i koshereve të bletëve është në rritje duke prodhuar 10 produkte me bazë mjaltin, të gjitha me veti të veçanta kurative, si rakia e mjaltit, uthulla e mjaltit apo pomada e propolisit.

Me një traditë në bletari që prej vitit 1975, z. Kastriot Sterjo kujdeset që të sjellë në treg mjaltë organik dhe mjaltë cilësor.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: kastriotog@gmail.com ose 068 28 89 466.

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë

zojdh të vendit

Produktet "Lufra"



Fabrika e përpunimit të qumështit "Lufra" nisi aktivitetin në vitin 1992, si punishte e thjeshtë, e improvizuar në një dhomë shtëpie. Sot, është shndëruar në një industri për përpunimin e qumështit, duke zgjeruar gamën e produkteve dhe shërbimeve në një treg më të gjerë konsumatorësh, në të gjithë Shqipërinë.

Për realizimin me sukses të punës, kompania "Lufra" i jep shumë rëndësi cilësive së lëndës së parë duke bashkëpunuar me fermerat më të mëdha në vend. Prodhoen me emërtimin "Lufra" produkte, si: qumësht, kos, djallë, gjalpë, djathë dhe salcë. E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: 068 90 22 120 ose në info@lufra.al

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë



zojdh të vendit

"Juga e Bardhë" Kantina Faba

E themeluar në vitin 1990, në qytetin e Fierit, kantina Faba në vite ka sjellë verëra të ndryshme. 'Juga e Bardhë' është verë e bardhë, e prodhuar nga kantina Faba, nga varietetet e rrushtit, si: Chardonnay dhe Sauvignon Blanc. Përsosmëria e saj vjen nga investimi më i fundit në teknologjinë e prodhimit. Frymëzuar nga romani i Jakov Xoxës, 'Juga e Bardhë', kjo verë përfaqëson të gjithë verërat e bardha të Shqipërisë Jugore, me shijen unike të saj.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: 0692951806 ose në altndriza@yahoo.com

AIDA përkrash prodhuesit shqiptarë

zojdh të vendit

Miell misri "Dieta"



Fabrika e miellit të misrit "Dieta" ka nisur punën në vitin 1997, në Elbasan. E fokusuar në prodhimin e miellit cilësor, falë përkushtimit e pasionit ka arritur të sjellë shumë produkte të tjera në treg, si: miell misri për ballokume, niseshte, miell thekre, miell misri të bardhë etj. Cilësia e lartë dhe teknologjia moderne e kanë kthyer miellin e misrit "Dieta", në një zgjedhje të sigurt.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: 069 205 3123 ose në info@dieta.al



AIDA përklar prodhuesit shqiptarë



"E kuqja shqiptare" Kantina Faba

Nga kombinimi i varieteteve të rrushit autokton shqiptar, Vlosh dhe Shesh i Zi, është krijuar vera e veçantë "E kuqja shqiptare", nga kantina Faba. Vjetrimi në fuçi lisi e bën akoma dhe më cilësore. Me ngjyrë të kuqe si ajo e flamurit dhe ideuar mbi vallet e shpatave, kjo verë ka një shije unike dhe është vlerësuar me çmimin e bronzit në Ballkan.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: 0692951806 ose në altindriza@yahoo.com



AIDA përklar prodhuesit shqiptarë



Kremviçe të tymosura - Hako

Kompania "Hako" e themeluar në vitin 1994, nga familja Hako, me aktivitet kryesor përpunimin e mishit numëron mbi 70 lloje sallamesh, proshutash dhe produkte të marinuara. Sistemet e menaxhimit të cilësisë dhe të sigurisë ushqimore e bëjnë kompaninë "Hako" shumë të besuar në produktet e saj. Me shije të veçantë, të tymosura dhe pamje elegante produkti "Kremviçe të tymosura - Hako" ka krijuar identitet në çdo tryezë.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: 069 20 27 250 ose në info@hako.al



AIDA përklar prodhuesit shqiptarë



Produkte "Tona"

Kompania "Tona Co" sh.p.k ka nisur aktivitetin në vitin 1992, në qytetin e Korçës. Me aktivitet kryesor përpunimin e mishit, kompania sot ka zhvilluar 80 produkte cilësore si: sallame dhe proshuta, mish i paketuar, conserva mishi, produkte me bazë pule, produkte salcash të ndryshme, produkte djathi industrial, etj.

Kompania "Tona Co" zhvillon aktivitetin e prodhimit sipas standardit ISO 9001 dhe HACCP, që produktet e saj të njihen dhe aprovohen në tregjet ndërkombëtare.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: +355 82 248 535 ose në info@tona.al



AIDA përklar prodhuesit shqiptarë



"Produktet Gjiofarm"

Rajoni i Gjirokastrës shtrihet në jug të Shqipërisë dhe prej shekujsh prodhon produktet më cilësore të bulmetit. Në këtë zonë, kompania "Gjiofarm" prodhon produkte tradicionale me të njëjtën shije dhe cilësi të trashëguar në vite. Vlerat dhe metoda tradicionale e trajtimit të bulmetit kombinohet me teknikat e reja të prodhimit brenda një fabrike moderne. Produktet kryesore që kjo kompani ofron janë: djathë i bardhë, djathë kaçkavall, qumësht dhe kos llope, gjizë dhe gjalpë. Kompania "Gjiofarm" për cilësinë dhe sigurinë e produkteve që ofron është certifikuar nga Sistemi HACCP. E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: 69 40 68 801 ose në gjiofarm@gjiofarm.com



AIDA përklar prodhuesit shqiptarë



Bio Produkte Merja

Bio Produkte Merja ka filluar aktivitetin e saj në vitin 1997 në qytetin e Tiranës duke ofruar bimët medicinale dhe erëzat. Në vitin 2014 krijuan fermën e parë në Lushnjë, ku kryhet grumbullimi, përpunimi i bimëve etero-vajore dhe erëzave të kuzhinës, prodhimi i vajrave bimorë e esenciale, ruajtja e përpunimi i bimëve në standarde të larta. Sot Merja Bioprodukte, vjen me një nsi të re në Shqipëri duke krijuar trajtime bimorë unike për çdo individ.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: 69 23 18 286 ose në ylli.merja@gmail.com.



AIDA përklar prodhuesit shqiptarë



ERZENI
PRODHIMET DËLMETET
Cilësi e garantuar

Cilësi dhe Standard European.
www.erzeni.com

Erzeni

Kompania e përpunimit të qumështit "Erzeni" ka nisur veprimtarinë e saj prej viti 1992. Operon në treg me prodhimin, paketimin, magazinimin dhe shpërndarjen e produkteve mjafit cilësore dhe të shijshme të bulmetit, si: qumësht, kos, djathë, gjalpë, salcë, dhallë etj. "Erzeni" grumbullon çdo ditë qumësht të freskët në 50 fshatra të vendit, duke bërë që produktet e prodhuara nga kjo kompani të dalin për standarde të larta sa i përket cilësisë dhe sigurisë së plotë ushqimore në shërbim të konsumatorit. Kompania "Erzeni" është e certifikuar nga sistemi HACCP dhe ISO 22000-2005.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën, në: info@erzeni.com ose në 0689093695



AIDA përkrah prodhuesit shqiptarë

zojdh të vendit

Sallam si qemoti

"FIX PRO" sh.p.k., sallameria e cila ushtron aktivitetin e saj prej vitit 2003, në qytetin e Korçës. "Fix pro" konkuron në tregun kombëtar dhe rajonal me shijen e veçantë të produkteve nga përpunimi i mishit. Ajo ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me standardet e cilësisë EN-ISO-22000: 2005.

Specialiteti i kompanisë është "Sallam si qemoti", i prodhuar sipas mënyrës tradicionale të krahinës, me tymosje nga një përzije drurësh.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@sallamfix.al ose 0686010388.



AIDA përkrah prodhuesit shqiptarë

zojdh të vendit

Produktet "KLEGEN"

Fabrika e përpunimit të qumështit "KLEGEN" u themelua në vitin 2003 si një ndërmarrje e specializuar për prodhimin e produkteve të bulmetit. Kompania e qumështit qumështin nga fermat e rajonit të Shkodrës, kryesisht nga zonat e Malësisë së Madhe. Produktet "KLEGEN" nuk përmbajnë konservantë dhe garantojnë një standard të lartë sigurie, pa dëmtuar vlerat ushqyese, duke ruajtur cilësinë dhe shijen tradicionale. "KLEGEN" njihet për shumëllojshmëri produktesh në treg, si: djathë dhe, kos, salcë kosi, gjalpë, krem djathi etj.

E duam shqip dhe zgjedhim tonën në: info@klegen.com ose +355 69 20 39 332

FORUME BIZNESI BILATERALE NË FUNKSION TË DIPLOMACISË EKONOMIKE TË SHQIPËRISË



FORUMI I BIZNESIT DHE INVESTIMEVE TURQI-SHQIPËRI

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve/AIDA mori pjesë në Forumin e Biznesit dhe Investimeve Turqi-Shqipëri. Eventi u organizua nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë në bashkëpunim me Union of Chambers and Commodity Exchanges of Turkey, për të çuar më tej bashkëpunimin dhe forcimin e marrëdhënieve ekonomike dypalëshe, kjo pasi Turqia ka qenë dhe mbetet një partner strategjik i rëndësishëm i Shqipërisë në rajon dhe më gjerë.

Ky takim online mbledhi së bashku zyrtarë të lartë, ambasadorë, përfaqësues të dhomave të biznesit dhe sipërmarrës, për të diskutuar mbi mundësitë e rritjes së bashkëpunimit mes dy vendeve. Me pjesëmarrjen e Ministres së Financave dhe Ekonomisë, znj. Anila Denaj, Ministrit turk të Tregtisë, z. Ruhsar Pekcan, Ambasadorit të Turqisë në Shqipëri, z. Murat Yörük dhe Ambasadorit të Shqipërisë në Turqi, z. Kastriot Robo etj.



Drejtoresha e Investimeve, në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, znj. Mileva Meksi në prezantimin e saj veçoi klimën pozitive të investimeve në Shqipëri, raportet tregtare mes dy vendeve, sektorët strategjikë dhe incentivat që shteti shqiptar ofron për investimet e huaja direkte, duke vlerësuar bashkëpunimin mes shteteve, si edhe mundësitë tregtare dhe investimet dypalëshe. Zgjerimi i pandalshëm i marrëdhënieve të shkëlqyera me Turqinë mbetet një nga prioritetet e rëndësishme të diplomacisë ekonomike të vendit tonë.

FORUMI I BIZNESIT SHQIPËRI-UKRAINË

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve u bë pjesë e Forumit të Biznesit Shqipëri-Ukrainë, organizuar nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë së Ukrainës, në kuadër të shqyrtimit të perspektivave të reja për forcimin e marrëdhënieve ekonomike dypalëshe.

Në fokus të veçantë të bisedimeve të këtij forumi ishin investimet, sektorët ekonomikë të turizmit dhe përpunimi i ushqimit.

Pjesë e takimit ishin Presidenti i Dhomës së Tregtisë së Ukrainës, z. Gennadiy Chyzykhov; Kryetarja e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, znj. Ines Muçostepa; Ambasadori i Ukrainës në Shqipëri, z. Volodymyr Shkurov; Ambasadorja e Shqipërisë në Poloni, znj. Shpresa Kureta dhe zyrtarë të tjerë të lartë.



Znj. Mileva Meksi, Drejtoresha e Investimeve, në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, në prezantimin e saj vlerësoi bashkëpunimin midis shteteve, mundësitë tregtare dhe investimet e dyanshme.

Takimi u mbyll me synimin për të vazhduar dhe rritur më tej bashkëpunimin ekonomik e tregtar mes Shqipërisë dhe Ukrainës.

AIDA ZGJERON RRJETIN AFTERCARE



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve edhe për vitin 2021 nisi punën, së bashku me partnerët vendorë, për t'i ofruar investitorëve ekzistues mbështetje gjithëpërfshirëse, jo vetëm në përkrahjen e riinvestimeve në zonë, por dhe në promovimin e resurseve. Pas ndikimit të lartë e të suksesshëm që pati programi "Investment Promotion & After-Care", duke konsideruar bashkitë aktorë kyç në punën e AIDA-s kundrejt biznesit, ka vijuar zgjerimi i bashkëpunimit me qeverisjen vendore.

KAVAJA, BASHKIA MË E RE PËR VITIN 2021 E RRJETIT AFTERCARE

Bashkia Kavajë, e para për vitin 2021, që i shtohet këtij bashkëpunimi, me hapjen e një sezoni trajnimit të stafit, realizuar nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve në bashkëpunim me GIZ Albania. Stafi i AIDA-s, gjatë takimit që zhvilloi, u prit nga nënkryetari, z. Cuxim Kola dhe anëtarë të kësaj bashkie.

Përgjegjësja e Sektorit të Investimeve & AfterCare, znj. Dorina Patuzi, bëri një prezantim të projektit, rolit dhe funksioneve të AIDA-s në mbështetje të riinvestimeve në vend, duke ofruar për Bashkinë e Kavajës asistencë për çdo projekt potencial apo nismë që mund të lindë në të ardhmen.



BASHKIA VORË, PJESË E NISMËS AFTERCARE TË AIDA-S

Në kuadër të angazhimit për të konsoliduar rrjetin e bashkëpunimit me partnerët vendorë, nëpërmjet programit AfterCare, Vora është bashkia e 10-të që i shtohet kësaj nisme, pas përfshirjes së Bashkisë Kavajë. Ekipi i AIDA-s, në bashkëpunim me GIZ Albania, zhvilloi trajnimin për drejtuesit dhe stafin e Drejtorisë së Taksave dhe Tatimeve të Bashkisë Vorë.

Znj. Dorina Patuzi, Përgjegjësa e Sektorit të Investimeve & AfterCare, prezantoi projektin, rolin dhe funksionet e AIDA-s në mbështetje të riinvestimeve në vend, duke ofruar asistencë për çdo nismë me vlerë. Theksi u vendos në ndikimin e shërbimeve AfterCare dhe rëndësinë që kanë në krijimin e një klime të favorshme për të rritur investimet e huaja në nivel lokal.



TAKIME AFTERCARE ME BIZNESE DHE SHKOLLA PROFESIONALE

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve zhvilloi takime AfterCare, në Bashkinë e Kavajës, me shkollën e mesme profesionale "Charles Telford Erikson" dhe me disa biznese në këtë qark. Përfaqësuesit e AIDA-s të Sektorit të Investimeve & AfterCare dhe Bashkisë Kavajë patën një qasje interaktive gjatë takimit.

Gjithashtu, u bë një prezantim i detajuar i rolit të Agjencisë dhe projektit AfterCare, i cili është në partneritet me GIZ. Shkollës iu ofrua mbështetje dhe asistencë për të ndërtuar ura komunikimi me biznese që operojnë në zonë, me objektivin për të përshtatur nevoja e tregut dhe të bizneseve me kurrikulat specifike që zhvillohen në shkollë.



TAKIME DHE VIZITA



TAKIM NË KOMPANINË EVEREST, NË KAMËZ

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në kuadër të asistimit dhe përkrahjes së pandërprerë ndaj sipërmarrjes në vendin tonë, zhvilloi një takim në kompaninë EVEREST, në Kamëz, Tiranë.

Kompania EVEREST operon në tregun vendas që prej vitit 1997, e specializuar në prodhimin e profileve të aluminit për sektorin automotiv. Me një përvojë shumëvjeçare në këtë sektor, kjo kompani, veç veprimtarisë së saj në ndërtimet civile e industriale, prodhimin e profileve cilësore të aluminit, tregtimin e markave më të njohura të aksesorëve të aluminit është edhe një kompani lider në prodhimin e fasadave strukturale dhe gjysmë strukturale. Kohët e fundit, me një investim në vlerën 1 milion euro, kompania zgjeroi aktivitetin edhe me linjën e produkteve të lyerjes.

Përfaqësuesit e AIDA-s, gjatë takimit, i sugjeruan dhe prezantuan kompanisë mundësitë më të mira për të realizuar objektivat afatshkurtra që do të sjellin zgjerimin e saj në të ardhmen. Gjithashtu, administrator i EVEREST u informua në mënyrë të detajuar edhe mbi procedurën e marrjes së statusit të investitorit strategjik.



VIZITË NË FABRIKËN E MIELLIT “DIAMOND”, NË VORË

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, si pjesë të takimeve periodike që organizon në mbështetje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme shqiptare, zhvilloi një vizitë pranë kompanisë së miell Diamond, në Vorë.

Fabrika e miellit “Diamond”, pjesë e Agro Blend sh.p.k., ka filluar prodhimin në vitin 2012. Gjatë këtyre viteve është veçuar në tregun vendas për prodhimin e miellit si dhe përpunimin e më shumë se 20 produkteve, duke plotësuar kërkesat e konsumatorëve dhe nevojat e tregut. Së fundi, ajo ka kryer investime të tjera për të nxjerrë produkte të reja. Në maj të vitit 2019, ka përfunduar fabrika e re e bluarjes së grurit të fortë dhe ajo e pastave "Diamond". Marka "Diamond Pasta", tashmë është prezantuar në tregun lokal dhe atë rajonal.



Përfaqësuesit e AIDA-s, informuan bashkëpronarët e kompanisë për aktivitetet mbështetëse që Agjencia ofron dhe sidomos, mbi procedurat e marrjes së statusit të investitorit strategjik. Në përfundim të vizitës, theksi u vendos në kërkesat dhe nevojat e kompanisë për të krijuar bashkëpunime që do të mundësonin zgjerimin e aktivitetit, si dhe rritjen e kapaciteteve eksportuese të produkteve “Made in Albania”.

NË QYTETIN E LUSHNJËS TAKIM ME KOMPANINË “DONI FRUITS”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në kuadër të përkujdesjes dhe vëmendjes së vazhdueshme ndaj bizneseve vendase, zhvilloi një takim në ambientet e kompanisë së fruta-perimeve “Doni Fruits”, në qytetin e Lushnjës.

“Doni Fruits” eksporton në 30 vende të botës, përfshirë dhe Lindjen e Mesme. Aktualisht, kompania ka mbi 100 punëtorë, si dhe bashkëpunon me mbi 2500 fermerë të zonës. Në vitin 2018, subjektit përfitoi lejen për ndërtimin e “Qendrës së grumbullimit, ruajtjes, shpërndarjes dhe eksportit të frutave dhe perimeve”, me një investim prej 9 milionë euro. Me anë të këtij investimit të ri kompania pritet të hapë 300-500 vende pune. Sipas z. Ejup Ahmeti, bashkëpronar i “Doni Fruits”, qendra do të ketë 33 dhoma frigoriferike dhe magazina për prodhimet bujqësore, me ruajtje dinamike të produktit deri në 2 vjet. Ky projekt do të nxisë prodhimin vendas dhe eksportin e produkteve ‘Made in Albania’.



Përfaqësuesit e AIDA-s gjatë takimit informuan bashkëpronarët e kompanisë për aktivitetet mbështetëse që Agjencia ofron, mundësitë dhe lehtësirat për nxitjen e eksporteve.

AIDA MBËSHTET SIPËRMARRJET E GRAVE

AIDA në Ditën Ndërkombëtare të Grave, ditën e përpjekjeve për ngritjen e mëtëjshme të rolit të gruas në të gjitha sferat e shoqërisë, realizoi një vizitë në sipërmarrjen e drejtuar nga një grua, për të frymëzuar të gjitha gratë në vendin tonë dhe për t'i inkurajuar që të arrijnë të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë.



Gjyms'Hana, studio arkitekture/interior design, e themeluar nga një grua është shembulli i fuqisë, kreativitetit, këmbënguljes, udhëheqjes, qëndrueshmërisë, vullnetit, entuziazmit për të përballuar sfidat, një burim frymëzimi për të arritur sukses në botën e biznesit.

AIDA në 8 Mars zgjedh të ndajë një model suksesti të gruas shqiptare në sipërmarrje.

TAKIME DERË MË DERË NË QYTETIN E FIERIT DHE TIRANËS - DËSHMI SUKSESI PËR FONDET E AIDA-S

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve në kuadër të monitorimit të fondeve, prezantimit dhe informimit mbi shërbimet EEN-Albania, zhvilloi takime Door to Door në ambientet e bizneseve F&L SHPK dhe Rozeta Murati (PF), në qytetin e Fierit, si dhe në ambientet e biznesit KITI Tekstil SHPK, në kryeqytet.

Kompania F&L, e themeluar në vitin 2004 në qytetin e Fierit, operon në sektorin e prodhimit dhe tregtimit të grilave e aksesoreve. Në vitin 2019 ka përfituar nga Fondi i Konkurrueshmërisë i AIDA-s me një projekt aplikues për konsulencë dhe certifikim ISO.

Përfitimi i grantit shtoi prodhimin dhe shitjet. Përveç tregut shqiptar, certifikimet kanë ndihmuar kompaninë të vazhdojë eksportin, i cili është rritur vit pas viti, duke pasur shitje në Greqi, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni dhe Bullgari.



Ndiqui videon: <https://www.facebook.com/investi-nalbania/videos/125696969484304>

Rozeta Murati (PF), ka nisur veprimtarinë si artizane prej vitit 2010 dhe merret me qëndistari, punë artizanale dhe metrazhe.

Nga AIDA, në vitin 2019, ajo ka përfituar nga Fondi i Ekonomisë Kreative një grant për krijim prototipi. Përfitimi i grantit e ka ndihmuar në rimëkëmbjen dhe zhvillimin e mëtëjshëm të biznesit.



Ndiqui videon: <https://www.facebook.com/investi-nalbania/videos/276286570656150>

KITI Tekstil, themeluar në vitin 2017 në Tiranë, operon në sektorin e tekstit, konfeksioneve dhe veshjeve të punës. Në vitin 2019, kompania ka përfituar nga Fondi i Konkurrueshmërisë i AIDA-s, të cilin e ka përdorur për implementimin dhe certifikimin ISO.

Përfitimi i grantit ka ndihmuar kompaninë të jetë më konkurruese në tregun vendas e të huaj, duke rritur cilësinë e prodhimit dhe vlerën e shtuar të punës. Përfaqësuesit e kompanisë u njohën edhe me shërbimet dhe asistencën që ofron EEN-Albania për identifikimin dhe gjetjen e partnerëve ndërkombëtarë.




Për më shumë ndiqni videon: <https://www.facebook.com/investinalbania/videos/4480583385303816>

AIDA NË TAKIM ME UNIONET E DHOMAVE TË TREGTISË SHQIPËRI-BULLGARI

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve mori pjesë në takimin e parë virtual që u organizua nga Ambasada e Shqipërisë në Bullgari në bashkëpunim me Unionet e Dhomave të tregtisë Shqipëri-Bullgari.

Fokusi kryesor i këtij takimi ishte vijimi dhe forcimi i bashkëpunimit mes institucioneve dhe entiteteve ekonomike të Shqipërisë e Bullgarisë, si dhe promovimi i dy vendeve.

Bullgaria është një vend partner i rëndësishëm për Shqipërinë, jo vetëm sa i përket integritit evropian, por edhe aspektit ekonomik, duke pasur parasysh potencialin për rritjen e shkëmbimeve tregtare.



Bullgaria është një vend partner i rëndësishëm për Shqipërinë, jo vetëm sa i përket integritit evropian, por edhe aspektit ekonomik, duke pasur parasysh potencialin për rritjen e shkëmbimeve tregtare.

Drejtoresha e Investimeve, në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, znj. Mileva Meksi ishte pjesë e panelit të diskutimeve krahas përfaqësuesve të lartë nga dy vendet, si: Ambasadori i Bullgarisë në vendin tonë, z. Momtchil Raytchevski; Ambasadorja e Shqipërisë në Bullgari, znj. Donika Hoxha; Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Bullgarisë, z. Tsvetan Simeonov; Kryetarja e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, znj. Ines Muçostepa; përfaqësues nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme etj.

Në këto kohë sfiduese, bashkëpunimi për të rindërtuar dhe rimëkëmbur është i domosdoshëm dhe dy vendet tona duhet të përdorin potencialin e pashfrytëzuar për rimëkëmbje më të shpejtë dhe më të mirë.

Klima liberale e biznesit dhe reforma e investimeve, kostot konkurruese të punës, popullsia e re dhe e arsimuar, stimujt konkurrues dhe sistemi i taksave, vendndodhja e përshtatshme gjeografike, potenciali i fortë rritës, hyrja e lirë në tregje të mëdha dhe stabiliteti makroekonomik janë disa nga arsyet pse duhet të investohet në Shqipëri.




Business Support on Your Doorstep

ENTERPRISE EUROPE NETWORK-ALBANIA (EEN-ALBANIA)

EEN-ALBANIA PJESË E PROJEKTIT TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË

Enterprise Europe Network-Albania dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve u bënë pjesë e projektit evropian për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës.

Ky projekt menaxhohet nga EU-OSHA, e cila është agjencia e informacionit e Bashkimit Evropian për sigurinë dhe shëndetin në punë. Në kuadër të kësaj iniciative, përfaqësues të AIDA-s dhe EEN-Albania, në cilësinë e EU-OSHA Ambasador, morë pjesë në takim virtual që u zhvillua midis përfaqësuesve të Agjencisë EU-OSHA, EASME, DG Grow dhe Ambasadorëve të EEN në OSH të shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve IPA.



Kjo iniciativë ka si qëllim suportin dhe informimin e bizneseve mbi rëndësinë e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, aplikimit të legjislacionit dhe rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë, si edhe për të përmirësuar gjithmonë cilësinë dhe kushtet e punës.

EEN-ALBANIA PËRKRAH SIPËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME PËR T'U BËRË PJESË E TREGUT EVROPIAN DHE MË GJERË

Enterprise Europe Network-Albania dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ftojnë të gjitha Sipërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) me fokus eksportin dhe që kërkojnë të gjejnë partnerë ndërkombëtarë biznesi, të bëhen pjesë e databazës së projektit EEN.

Enterprise Europe Network është Rrjeti më i madh në botë që ofron shërbime pa pagesë për mbështetjen e Sipërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme/NVM për të qenë pjesë e tregut evropian e më gjerë.

Rrjeti në Shqipëri ofron disa shërbime, si: Këshillim dhe mbështetje; Partneritete ndërkombëtare; Pjesëmarrje në aktivitete.

Informohuni më shumë mbi mundësitë e partneritetit në linkun: <https://een.ec.europa.eu/partners>

Për t'u bërë pjesë e databazës së projektit, apo për të marrë akoma më shumë informacion mbi mundësitë që #EEN ofron nëpërmjet specialistëve të AIDA-s, kontaktoni nëpërmjet adresës së e-mailit info@aida.gov.al



WEBINARE



TRAJNIM/SESION INFORMUES PËRGATITOR PËR KOMPANITË EKSPORTUESE SHQIPTARE, MBI PJESËMARRJEN NË PANAIRIN VIRTUAL "BIOFACH 2021"

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve në bashkëpunim me partnerin SIPPO, në kuadër të zhvillimit të panairit kryesor të Tregtisë Botërore për Ushqimin Organik "BIOFACH/VIVANESS, organizuan një trajnim/sesion informues përgatitor për kompanitë eksportuese shqiptare, mbi pjesëmarrjen në panairin virtual "BIOFACH 2021", si edhe mbi mundësitë që ofron tregu evropian i produkteve organike.

Qëllimi kryesor i këtij sesioni informues lidhet me evidentimin e nevojave kryesore të kompanive shqiptare, të sektorit organik, për trajnime të ndryshme dhe pjesëmarrjen në panairin online dhe jo vetëm.

Trajnimi u zhvillua nga Gustavo Ferro, ekspert pranë SIPPO-s, i specializuar në fushën e produkteve organike në bashkëpunim me ekspertët e AIDA-s. Pjesëmarrës në këtë webinar ishin sipërmarrës shqiptarë eksportuesë që operojnë në sektorin organik.



E-COMMERCE | INOVACION DHE ZHVILLIM PËR BIZNESET

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve/AIDA dhe Enterprise Europe Network-Albania/EEN-Albania zhvilluan webinarin me temë: "E-commerce | Inovacion dhe zhvillim për bizneset". Ky takim online pati si qëllim të informojë sipërmarrjet shqiptare për përdorimin e platformave novatore e-commerce, që ndihmojnë bizneset të jenë më konkurruese dhe të përmirësojnë procesin e të bërit biznes në treg. AIDA dhe EEN-Albania synuan që nëpërmjet këtij webinari informues sipërmarrësit në Shqipëri të njihen me tregtinë elektronike, si dhe rrugën e prezantimit dhe forcimit të saj si pjesë e rëndësishme e strategjisë së rritjes së biznesit. Fokusi lidhet kryesisht me përçimin e informacioneve më thelbësore për tregtinë elektronike, mënyrat e ndryshme me të cilat kompanitë mund të përdorin tregtinë elektronike, si dhe gatishmëria e tyre për të pasur tregtinë elektronike si pjesë të biznesit.

Dritan Mezini, ekspert ICT, në prezantimin e tij u fokusua kryesisht, në: tregtinë elektronike, biznesin elektronik, një historik të shkurtër, avantazhet/disavantazhet, tipet/modelet e biznesit, sfidat, hapat për të nisur tregtinë elektronike, gatishmëria e SME-ve, tregtia elektronike në vendin tonë dhe konkretisht edhe në situatën e Covid-19 etj. Në këtë webinar morën pjesë sipërmarrës shqiptarë, ekspertë/profesionistë me përvojë në fushën e tregtisë elektronike.

Ndiqu regjistrimin e webinarit në linkun: <https://www.facebook.com/investinalbania/videos/875612193013264>



RUBRIKA | WEBSITE



PLATFORMA “BUSINESS TO BUSINESS”

Në web faqen e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) është e publikuar platforma “Business to Business”, (B2B) që ju vjen në ndihmë NVM që veprojnë në Shqipëri.

B2B është një rrjet aktiv, i cili ofron mundësinë për bashkëpunime dhe investime të suksesshme midis bizneseve.

Kjo platformë është një “mekanizëm” lehtësues që krijon mundësi për bashkëpunime frytdhënëse dhe për të zgjeruar kontaktet në botën e biznesit.

AIDA, ju fton të regjistroheni ose përditësoni të dhënat tuaja në platformën B2B, duke na kontaktuar në adresën zyrtare: info@aida.gov.al

Për t'u njohur me platformën B2B vizitoni linkun: <http://aida.gov.al/b2b/>

PLATFORMA BUSINESS TO BUSINESS


RUBRIKA COVID-19

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, (AIDA) si pasojë e situatës së krijuar prej pandemisë COVID-19, për t'ju ardhur në ndihmë bizneseve vazhdon të përditësojë me informacionet më të fundit rubrikën “COVID-19”.

Në të publikohen iniciativat e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare për të përballuar situatën, informacionet më të reja në lidhje me paketat financiare në ndihmë të biznesit, aplikimet për programet e mbështetjes së biznesit, projektet, nismat e tjera publike, si edhe lidhje e kontakte të rëndësishme.

Rubrika ka si qëllim aksesin dhe qarkullimin e informacioneve më të rëndësishme, në një kohë sa më të shpejtë, për një koordinim më të mirë mes palëve.

Për t'u njohur me publikimet më të fundit në këtë rubrikë vizitoni linkun: <http://aida.gov.al/covid-19/>



COVID-19



PËRDITËSIME DHE INFORMACIONE

ZEROHET TATIMI MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Biznesi i vogël me xhiro vjetore deri në 14 milionë lekë, duke nisur nga 1 janari 2021, nuk do të paguajë tatimin mbi fitimin.

Nga ky vendim i Parlamentit çlirohen nga barra fiskale, për një periudhë 9-vjeçare, rreth 90% e bizneseve që operojnë në tregun vendas.

Zerimi i tatimfitimit është një masë lehtësuese për atë kategori biznesi që konsiderohet më vulnerabël, sidomos në situatën e vështirë financiare të krijuar nga COVID-19.



SKEMA E MBËSHTETJES ME NAFTË PËR BUJQËSINË

Qeveria Shqiptare, prej datës 15 janar, nisi aplikimin e skemës së mbështetjes me naftë për bujqësinë, për vitin 2021. Skema e përfitimit të karburantit për bujqësinë mund të përfi-tohet nga të gjithë fermerët me NIPT fermeri ose subjekteve me NIPT tregtar (persona fizike apo juridikë) me veprimtari të prodhimit bujqësor, të cilët kanë në pronësi apo në përdorim/me qira tokë bujqësore, disponojnë ferma në madhësi jo më pak 0.4 Ha, e përbërë nga parcela me sipërfaqe jo më pak se 0.1 Ha secila, si dhe që punojnë tokën dhe i shërbejnë kulturave bujqësore me mjete të mekanizuara.

Nëpërmjet kësaj mbështetje, fermerët do të mund të përfi-tojnë mesatarisht nga 70-100 L naftë falas, për çdo hektarë tokë të mbjellë, në varësi të kulturave bujqësore. Aplikimi online në portalin e-Albania, gjatë periudhës 15 janar 2021-25 shkurt 2021.



MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË: SHTYHET AFATI PËR GARANCINË SOVRANE

Të gjitha subjektet e interesuara mund të aplikojnë për Garancinë Sovrane deri në datë 30 qershor 2021.

Shtyrja e afatit do t'u mundësojë më shumë bizneseve, aktiviteti, i të cilave është goditur nga pandemia e Covid-19, të përfitojnë. Deri në fund të muajit dhjetor 2020 kanë përfituar 308 biznese, kryesisht në sektorin e tregtisë, shërbimit e prodhimit, në një vlerë totale prej rreth 8.95 miliardë lekë.

Aplikimi në linkun: <https://www.financa.gov.al/mfe-shtyhet-afati-per-garancine-sovrane-deri-ne-30-qershor-2021>

EKSPORTUESIT SHQIPTARË MUND TË EKSPORTOJNË PRODUKTE BUJQËSORE PA TAKSË DOGANORE NË BE DERI NË VITIN 2025

Bashkimi Evropian ka zgjatur skemën pa taksa për importin e frutave dhe perimeve nga vendet e Ballkanit Perëndimor deri në fund të vitit 2025.

Sipas ndryshimit të mëparshëm të rregullores, regjimi pa taksa për importet e frutave dhe perimeve nga Ballkani Perëndimor do të skadonte në fund të vitit 2020.

Në këtë kuadër, përveç mollëve, kumbullave & misrit të ëmbël, gjatë 5 viteve të ardhshme, produktet shqiptare që mund të eksportohen pa paguar taksë doganore në BE, ndër të tjera janë patatet, kungujt e njomë, kërpudhat, rrushi, kajsitë, qershitë, kosi qersh, nektarina, pjeshka, luleshtrydhja, arra, pjeperi dhe fruta të ndryshme agrumesh. Tarifat preferenciale janë lehtësira doganore (tarifa pa taksa ose tarifa të reduktuara 0).

Për më shumë shihni në faqen web të DP. Doganave.

LANÇOHET INSTRUMENTI KËSHILLIMOR I GIZ-“COSOLVE-19”, DEDIKUAR BIZNESEVE MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME SHQIPTARE

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve informon se GIZ ka lançuar Instrumentin Këshillimor- “CoSolve-19”. Qeveria gjermane dhe ajo shqiptare kanë ngritur këtë instrument këshillimor për të zbutur pasojat e krizës së Covid-19. Kjo nismë e përbashkët, do t'u ofrojë Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) këshillim dhe trajnime, sipas nevojave të tyre, për t'i përkrahur që të përshtaten me situatën e re të shkaktuar nga pandemia. Linjat sektoriale, që përfitojnë nga “CoSolve-19”, janë si në vijim:

Turizëm: NMVM akomodimi (hotele, agroturizëm, bujtina, kampingje), operatorë turistikë të regjistruar dhe guida turistike, objekte shërbimi (bare & restorante në zonat rurale që ofrojnë aktivitete turistike).

Bujqësi: Fermerë individualë (me NIPT aktiv fermeri), shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, NMVM-të që ushtrojnë aktivitetin e tyre në prodhimin, grumbullimin, përpunimin, marketimin dhe shitjen e produkteve bujqësore.

Të tjerë: NMVM-të që janë prodhues të tekstileve dhe veshjeve, lëkurës dhe këpucëve, biznese të artizanatit, ofrues të shërbimeve etj., si dhe biznese të tjera që janë dëmtuar si pasojë e Covid 19.

Informacione më të detajuara gjenden në faqen: <https://cosolve19.al/>

Videon e lançimit e gjeni në linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=FnjHFbBhWes>

THIRRJA E DYTË E PROJEKTIT ELIIT - JAVA E INDUSTRIËS SË BE-SË

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve njofton se hapet thirrja e dytë për aplikim për Projektin ELIIT 'The European Light Industries Innovation and Technology', një iniciativë e financuar nga Programi COSME i Bashkimit Evropian.

Projekti ELIIT është një program që nxit bashkëpunimin midis NVM-ve aktive në sektorët e tekstitit, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve dhe ofruesve të teknologjisë me zgjidhje novatore. Në kushtet e sotme të transformimit digjital, synohet që falë integritimit të teknologjive moderne, performanca e NVM-ve të industrisë së lehtë të kalojë në një stad të ri zhvillimi.



Bordi drejtues i ELIIT do të përzgjedhë 25 partneritete, midis NVM-ve dhe ofruesve të teknologjisë, të cilët do të përfitojnë: 70,000 € mbështetje financiare; një program trajnimi, pjesëmarrje në workshop/konferenca dhe ekspozita, për zgjerimin e tregut dhe për të vendosur kontakte të reja biznesi. Afati i fundit për aplikim në këtë projekt, data 14 prill 2021. Vizitoni faqen zyrtare: <https://ec.europa.eu/eliit>

THIRRJA IV #CHALLENGEFUND PËR START-UP DHE ORGANIZATAT PËR MBËSHTETJEN E INOVACIONIT/ISO

AIDA nëpërmjet Ambasadës së Suedisë në Shqipëri informoi për Thirrja e 4-ërt #ChallengeFund. Mund të aplikojnë Start-Up-et (e regjistruara midis 0-5 vjeç) dhe Organizatat për Mbështetjen e Inovacionit/ISO, deri më 15 mars 2021. Për kategorinë Start-Up, fushat që kanë përparësi, janë: Agrikultura; Zgjidhje digjitale (produkte dhe/ose shërbime digjitale); Zgjidhje novatore, të cilat lehtësojnë sfidat e lidhura me pandeminë Covid-19.



Programet që kanë përparësi për kategorinë Organizata që Mbështetin Inovacionin/ISO, janë: Gratë sipërmarrëse; Lidhje dhe akses tek aktorë të sektorit privat dhe/ose investitorë potencialë; Akses në rrjetet dhe programet rajonale dhe ndërkombëtare, që fuqizojnë ekosistemin e sipërmarrjes në Ballkan; Ekonomi e gjelbër/cirkulare; Zgjidhje digjitale (produkte dhe/ose shërbime digjitale).

Faqja web: <https://challengefund.euforinnovation.al/>



BOTIME

BOTIMI STATISTIKOR- SKEMAT E FINANCIMIT TË MENAXHUARA NGA AIDA, 2014-2019

Publikohet "Botimi statistikor - Skemat e financimit të menaxhuara nga AIDA, 2014-2019", një raport statistikor që përmban të dhëna, nga viti 2014-2019, për ecurinë dhe zbatimin e fondeve të menaxhuara nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve.

Në të jepen shifra konkrete të buxhetit, aplikimeve dhe përfituesve. Gjithashtu, gjenden edhe analiza të të dhënave, me qëllim pasqyrimin e impaktit të këtyre politikave në mjedisin ekonomik dhe atë të bërjes biznes nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme shqiptare.

**SHFLETO BROSHURAT
E REJA TË AIDA-S**



BOTIM STATISTIKOR

SKEMAT E FINANCIMIT TË MENAXHUARA NGA AIDA

2014 - 2019



Rruga Skërdilajd Llaçami, Nd.1, Tiranë, Shqipëri
tel: +355(0)42251001 | email: info@aida.gov.al | web: aida.gov.al

AIDA
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

Botimi statistikor mund të shfletohet online, në faqen e AIDA-s, linku:


<https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/761-botim-statistikor-mbi-skemat-e-financimit-te-menaxhuara-nga-aida-2014-2019>

STATISTIKA



RAPORTI I UNCTAD PËR INVESTIMET BOTËRORE PËR VITIN 2020


Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD) ka publikuar raportin e Investimeve Botërore për vitin 2020. Efektet e pandemisë kanë ndikuar mbi investimet e huaja direkte në nivel global. Sipas këtij raporti parashikohet që edhe për vitin 2021 rritja e IHD-ve në shkallë globale të mbetet e dobët.



EFEKTET E PANDEMISË MBI INVESTIMET E HUAJA DIREKTE GLOBALE (IHD) NË VITIN 2020 DHE PARASHIKIMET PËR VITIN 2021

BURIMI: UNCTAD

- Në vitin 2020 IHD u ulën me **42%** në shkallë globale, ose me rreth **USD 859 miliardë**.
- Në vendet e zhvilluara flukset e IHD ranë me **69%** në rreth **USD 229 miliardë**. Flukset drejt Evropës ranë plotësisht, por gjithashtu edhe SHBA pësuan një rënie të ndjeshme (-49%) me USD 134 miliardë.
- Rënia e IHD-ve globale për ekonomitë në zhvillim ishte me **12%** në rreth **USD 616 miliardë**.
- Lista e vendeve përfituese të IHD globale në 2020 u kryesua nga **Kina**.



EFEKTET E PANDEMISË MBI INVESTIMET E HUAJA DIREKTE GLOBALE (IHD) NË VITIN 2020 DHE PARASHIKIMET PËR VITIN 2021

BURIMI: UNCTAD

- Për vitin 2021 pritet që rritja e IHD-ve në shkallë globale të mbetet e dobët meqenëse ende në sektorët industrialë nuk shihet rritje në projektet e zhvillimit.
- Investimet ndërkombëtare në sektorët e infrastrukturës mund të rezultojnë më të forta, të mbështetura nga paketat e mbështetjes ekonomike në vendet e zhvilluara.
- Për vendet në zhvillim përbëjnë shqetësim tendencat e flukset në rënie të IHD-ve që janë thelbësore si për kapacitetin prodhues ashtu dhe për zhvillimin e infrastrukturës, pra duke mos garantuar perspektivat e qëndrueshme të rimëkëmbjes ekonomike.

RRITJA E EKSPORTEVE SHQIPTARE SIPAS INSTAT

Sipas Institutit të Statistikave/INSTAT në janar 2021 eksportet e mallrave u rritën me 3,1%, në krahasim me janar 2020. Për sektorin e bujqësisë, eksporti i zarzavateve dhe frutave u rrit me 102%, në raport me një vit më parë. Totali i eksporteve të këtij grupi, në janar 2021 arriti vlerën e 451 milionë lekë, nga 203 milionë lekë që ishte në janar 2020.



3.1%

RRITJE E EKSPORTEVE TË MALLRAVE

JANAR 2020 - JANAR 2021



102%

RRITJE E EKSPORTIT TË ZARZAVATEVE DHE FRUTAVE NË RAPORT ME NJË VIT MË PARË

JANAR 2020: 203 MILIONË LEKË EKSPORTE

JANAR 2021: 451 MILIONË LEKË EKSPORTE

INVESTIMET E HUAJA




KOMPANI TË HUAJA SYNOJNË PARTNERË BIZNESI NË SHQIPËRI

“GLENCORE”

Kompania zvicerane “Glencore” ka shprehur interesin për të vendosur kontakte dhe partneritet me subjekte dhe palë të interesuara në Shqipëri. Ajo është një nga kompanitë më të mëdha në përpunimin e burimeve natyrore, me një larmishmëri globale.

E themeluar në vitin 1974, si një kompani tregtare, kompania zvicerane është një nga prodhuesit dhe tregtarët kryesorë të produkteve që dalin nga përpunimi i qymyrit termik dhe naftës së papërpunuar, produktet e naftës dhe gazit natyror.



Numëron rreth 160,000 të punësuar në të gjithë botën. Operacionet e kësaj kompanie përfshijnë rreth 150 zona minierare dhe metalurgjike, si dhe asete të prodhimit të naftës në të gjithë botën. “Glencore”, përpunon: metale dhe minerale, përfshirë produktet e çelikut, bakrit, kobaltit, nikelit, zinkut dhe plumbit, lidhjeve metalike, aluminit, xeherorit të hekurit, arit dhe argjendit.

Produktet e energjisë, si: qymyri termik dhe nafta e papërpunuar, produktet e naftës dhe gazi natyror. Për shkak të zgjerimit në zinxhirin e furnizimit, si dhe rritjes së aktiviteteve të prodhimit, “Glencore” kërkon furnizues të rinj, të krijojë kontakte me kompani shqiptare që mund të eksportojnë në Zvicër.

Faqja web: www.glencore.com

“ECOL-UNICON”

Kompania polake “Ecol-Unicon” kërkon partnerë tregtarë në Shqipëri. “Ecol-Unicon” është shpërndarësi më i madh polak i pajisjeve për mbrojtjen e ujit dhe marka me e mirë e njohur në trajtimin e ujit të shiut, teknologjinë e pompimit dhe kontrollin e aromës.

E themeluar në vitin 1996, kompania ka si objektiv përmirësimin e cilësisë së ujit. Ajo ka një rrjet të mirëzhvilluar këshillimor dhe tregtar me degë në disa nga qytetet kryesore të Polonisë, 3 fabrika të prodhimit të betonit të parapërgatitur dhe fabrikën e prodhimit të kontrollit automatik.



“Ecol-Unicon” synon mundësi të reja, për të zgjeruar aktivitetin e saj edhe në tregun shqiptar.


Ka një gamë produktesh, të tilla si: stacionet e pompimit të puseve të thata, me sistemin e ndarjes së ngurtë, stacionet e pompimit, ndarës të vajit të lehtë dhe yndyrës, filtra kundër aromës, vendosjen e tankeve, puse betoni dhe elemente pusi.

Kompania “Ecol-Unicon” kërkon të bashkëpunojë me kompani shqiptare, jo vetëm me shpërndarësit, por edhe me prodhuesit apo kompanitë e shërbimeve.

Faqja web: <https://en.ecol-unicon.com/>

“HERBAPOL” SA

Kompania polake “Herbapol” SA kërkon partnerë dhe distributorë. “Herbapol” SA, e përfaqësuar nga Hanna Miechowiak, operon në fushën mjekësore dhe farmaceutike.




E specializuar në prodhimin e produkteve farmaceutike bazuar në lëndë të para bimore është veçuar si prodhuesi më i madh i ilaçeve bimore në Poloni. Cilësia shumë e lartë e produkteve sigurohet falë mbledhjes së lëndëve të para në zona ekologjikisht të pastra si dhe nga përmbushja e standardeve të sigurisë, ku secila fazë e prodhimit i nënshtrohet një kontrolli rigoroz në laboratorë të posaçëm. Për dekada, “Herbapol” SA, ka prezantuar përgatitjet bimore moderne, duke kombinuar arritjet e mjekësisë natyrale me teknologjinë më të avancuar.

Synon gjetjen e partnerëve që mund të bashkëpunojnë edhe për prodhimin e brendit të tyre nën brendin e kompanisë shqiptare.

Faqja web: <https://herbapol.pl/en/>

“POL-MARE”

Kompania polake “POL-MARE” kërkon partnerë tregtarë në Shqipëri. “POL-MARE”, e përfaqësuar nga Bartłomiej Pałucha, në fushën e transportit dhe logjistikës, operon në transporte ajrore, detare dhe tokësore prej vitit 2001.



Kompania kryen shërbimin e transportit special dhe me rëndësi strategjike për sa i përket objekteve ushtarake, të rënda dhe lëndëve të rrezikshme të të gjitha klasave. Mbartja e mallrave nga toka, ajri dhe deti realizohet me siguri të lartë, duke përfshirë të gjithë shërbimin, nga marrja deri në dorëzimin e ngarkesës në vendmbërritjen finale.


“POL MARE” dëshiron të ofrojë shërbimin e saj të specializuar edhe për tregun shqiptar, duke siguruar cilësi të lartë dhe garanci në çdo transport.

Faqja web: <http://pol-mare.pl/en>

“KSK DEVELOPMENTS”

Kompania polake “KSK Developments” kërkon partnerë publikë dhe privatë. “KSK Developments”, e përfaqësuar nga Marek Kasperek, ka në fokus krijimin dhe zbatimin e zgjidhjeve në fushën e IT dhe ICT, duke ofruar një gamë të gjerë shërbimesh që përmirësojnë cilësinë e jetës së banorëve.

Kompania synon të zgjerojë rrjetin e zbatimit të projektit për menaxhimin e hapësirës së parkimeve publike dhe parkimeve në hapësirat e jashtme në qytet.



Sistemi i Udhëzimit të Trafikut dhe Parkimit të “KSK Developments” është një produkt inovativ. Nëpërmjet tij, kompania ofron zgjidhje ‘smart’ ku hapësirat e lira të parkimit mund të monitorohen nga sensori magnetik që është një detektor me wireless.

Informacioni nga sensori përçohet në server dhe më pas në aplikacionin e smartphone-it, duke identifikuar në kohë reale vendet e disponueshme për drejtuesit e automjeteve, në pikën e tyre më të afërt.


Janë në kërkim edhe të një zhvilluesi për një software dhe APP, për të vënë në zbatim këtë projekt.

Faqja web: www.ksk-dev.com

“ARROW OPERATIONS AND TECHNOLOGIES LTD”

Kompania izraelite “Arrow Operations and Technologies Ltd”, e cila është një kompani globale dhe inovative me përvojë 30-vjeçare kërkon të bashkëpunojë me një partner/kompani në Shqipëri.

Kompania së fundi, synon të shtrijë aktivitetin e saj në Shqipëri dhe të bashkëpunojë me një partner/kompani në vendin tonë.



Është e specializuar në projektimin, zhvillimin dhe zbatimin e zgjidhjeve teknologjike komplekse dhe me kosto efikase për ujërat e ndotura dhe materialet e rrezikshme brenda industrive kimike, petrokimike dhe minierave.

Faqja web: <https://ecoarrow.com/>







AIDA

ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

 info@aida.gov.al  aida.gov.al  +355 (0)42 251 001  [@investinalbania](https://twitter.com/investinalbania)

 [@aida__albania](https://www.instagram.com/aida__albania)  AIDA - Albanian Investment Development Agency

 AIDA - Albanian Investment Development Agency